

# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI



KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES SË NXËNËSVE NË FUND TË CIKLIT TË TRETË TË SHKOLLËS FILLORE

## UDHËZIM

**KOHA PËR ZGJIDHJEN E TESTIT ËSHTË 70 MINUTA.**

Mos e hap testin dhe mos fillo t'i zgjidhësh detyrat para se të japë leje mësimdhënësi kujdestar.

Testi **DUHET** të jetë i shkruar me laps kimik ose me stilolaps.

Shkruaj lexueshëm dhe me shkronja dore.

Nëse shkruan me shkronja shtypi, thekso shkronjën e madhe atje ku duhet të jetë. Respekto rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore. Nëse mendon se ke gabuar në zgjidhjen e detyrës, vendos një vijë të kryqëzuar (X) mbi të dhe zgjidhe përsëri.

**Nuk guxon ta përdorësh korrektorin.**

Detyrat nuk e ke për detyrë t'i zgjidhësh me rend ashtu siç janë dhënë në test.

Nëse e përfundon punën më parë, kontrolloji edhe një herë zgjidhjet tua.

**Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:**

- ▶ është e pasaktë
- ▶ është e palexueshme dhe nuk është e qartë
- ▶ është e shkruar me laps grafit/të thjeshtë
- ▶ është shkruar ose rrethuar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë

**ME FAT!**

**SHIFRA E NXËNËSIT**



# FAQJA E ZBRAZËT

## Lexo tekstin dhe përgjigju në pyetjet 1, 2, 3, 4 dhe 5.

### PANAIRI I ARTIZANATEVE VENDORE NË SHKODËR

Si pjesë e projektit „Promovimi i rrjeteve dhe shkëmbimeve në vendet e Evropës Juglindore - Liqeni i Shkodrës”, zyrat e REC (Qendra Rajonale për Mjedisin për Evropën Qendrore dhe Lindore) në Shkodër dhe Podgoricë nga data 1 derë më 3 shkurt, organizuan një panair të përbashkët të artizanateve vendase me pjesëmarrës nga Mali i Zi dhe Shqipëria. Panairi u organizua në Shkodër dhe mbledhi rreth 50 ekspozues nga rajoni i Liqenit të Shkodrës, nga të dy vendet.

Punimet e ekspozuara përfshinin objekte nga materiale të ndryshme, të cilat zakonisht përdoren në këtë rajon. Megjithatë, ekziston një ide për t'i ekspozuar këto produkte në tregun më të madh turistik, duke pasur parasysh se ato përfaqësojnë vlerat primare të këtij rajoni dhe se si të tilla mund të mbështesin zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm në të dy anët e liqenit të Shkodrës. Në këtë kuptim, synimi i panairit ishte promovimi i produkteve të krijuara në rajonin e Liqenit të Shkodrës, si një potencial i madh i popullatës vendase në zhvillimin e turizmit në këtë zonë.

Produktet e ekspozuara ishin kryesisht prej: pambuku, kallami, argjendi, lëkura. Mund të gjendej edhe mjaltë, raki, verë dhe fruta të thata. Në panair kishte shumë vizitorë, ata vinin nga Hungaria, Bullgaria, Zvicra, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi.

Ceremonia e hapjes së panairit ishte e jashtëzakonshme, si për shkak të numrit të vizitorëve, ashtu edhe për shkak të interesimit të madh për produktet e ekspozuara. Pas tre ditësh, sa zgjati panairi, mund të themi se organizatorët ishin jashtëzakonisht të kënaqur, sepse u arritën disa nga qëllimet themelore të projektit REC-SDC (Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim): përmirësimi i bashkëpunimit ndërkufitar, forcimi i rrjetit të prodhuesve të artizanatit vendas, si dhe promovimi i produkteve vendore nga rajoni i Liqenit të Shkodrës.

*(Përgatitur nga teksti Veprimtaritë e Qendrës Rajonale për Mjedisin, Buletini, 2006)*

#### 1. Në cilin vit është mbajtur panairi i artizanateve vendore në Shkodër?

1. 2006.
2. 2016.
3. 2023.

*Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.*

1 pikë

#### 2. Shkruaj çfarë do të thotë shkurtesa REC.

1 pikë

#### 3. Nga të cilat materiale ishin prodhimet e ekspozuara?

2 pikë

4.

Ekspozuesit në panair ishin nga Hungaria, Bullgaria, Zvicra, Kroacia, Bosnje e Hercegovina, Serbia dhe Mali i Zi.

(Rretho PO ose JO dhe argumentoje zgjedhjen tënde.)

PO                      JO

Argumento.

1 pikë

5.

Çfarë është qëllimi i panairit?

1 pikë

6.

Dallo dhe shkruaj mbi vija bashkëtingëlloret grykore dhe bashkëtingëlloret dybuzore.

D, P, L, T, K, S, R, Y, M, Z, H, O, Q, G, V, F, B, I, A,

Bashkëtingëlloret grykore \_\_\_\_\_

Bashkëtingëlloret dybuzore \_\_\_\_\_

2 pikë

7.

Nga emrat e qyteteve të mëposhtme formo emërtimet e banorëve të tyre, ashtu siç kemi filluar.

*Shkodër*      -an                      =      *shkodran*

*Tiranë*                      -anin                      =      \_\_\_\_\_

*Tivar*                      -anin                      =      \_\_\_\_\_

1 pikë

## NË MUNDËSH

Në mundsh të ruash arsyen kur bota humbet fillin  
e fajin ty ta hedh dhe vetes t'i besosh,  
sa herë tek ti dyshojnë e s' të përfillin,  
por edhe dyshimet drejt t'i gjykosh...

në mundsh të rrish në pritje nga pritja pa u lodhur,  
a kur t'urrejnë, urrejtje mos t'ushqesh,  
madje ndaj shpifjeve të rrish pa folur,  
me thjeshtësi me to pa rënë ndesh...

në mundsh t'mendosh, por jo gjer në shkatërrim,  
të ëndërrosh, por jo si rob ëndërrimesh.  
dhe t'i trajtosh njëlloj e pa dallim,  
ngadhnjim e shpartallim, burim mashtrimesh...

**8.** A) Kush është autori i vargjeve të dhëna?

1 pikë

B) Në çfarë forme është ndërtuar poezia nga e cila janë shkëputur këto vargje?

1 pikë

**9.** A) Ku e vë theksin autori i këtyre vargjeve?

1 pikë

B) Çfarë rime përdor autori në këtë poezi? Shkruaje shembullin e përdorimit të saj.

Rima: \_\_\_\_\_

Shembulli: \_\_\_\_\_

2 pikë

**10.** Kjo poezi tregon sugjerimet që poeti i drejton:

1. babait
2. nënës
3. të birit

*Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.*

1 pikë

**11.** A) Në cilën vetë autori i drejtohet lexuesit?

1 pikë

B) Argumentoje përgjigjen nën A) me një varg nga teksti.

1 pikë

**12.** Rishkruaji fjalitë duke respektuar rregullat drejtshkrimore.

1. futbollistat strvitën shumë

1 pikë

2. shitoria ishte plotë mallëra

1 pikë

**13.** A) Rretho numrin para shkurtesës së shkruar saktë.

1. psh. (për shembull)
2. kg. (kilogram)
3. faq. (faqe)

1 pikë

B) Nënvizoj klasën e fjalës e cila nuk i përket vargut.

flas këndoj ndihmoj bukur

1 pikë

**Lexo fragmentin nga Nita (J. Rela) dhe përgjigju në pyetjet 14, 15, 16, 17 dhe 18.**

**AKTI III**

Pamja e parë

NITA - ( e veshur si mashkull, duke parë diku larg)... Tre muaj që jam veshur me këto rroba... se jam "mashkull"!... Mashkull! Po, mashkull për katundin, për njerëzinë, për djemtë e vajzat dhe për punë. Mirë, për punë. Le të vijë puna e mashkullit sado e rëndë, me vullnet e me dashuri e punoj, sepse tamam në këtë punë e harroj veten dhe hallin tim... Kur puna s'ma humbet mendjen, mendimi më shkon atëherë larg, atje larg, mbas detit e malesh, atje ku më ka mbetur zemra ... atje..( E nxjerr medaljonin, e puth e më zë të ëmbël thotë): Zef, o Zef, ku të kam? A të kam gjallë, Zef? A do të dëgjoj ndonjëherë ndonjë lajm për ty? Po të pres Zef! Ndaj i kam veshur këto rroba, që ma rrjepin lëkurën!... Pse s'qëndrova atje ku je ti? O, jo, jo!

Çfarë marrëzish po flas? Po të kisha mbetur atje, do të bija në duar të tyre dhe askush s'do të më ndihmonte dot. Kështu, kështu zemra më ka akoma shpresë... Kush e di? Të gjatë kanë qenë për mua këta tre vjet, por, duke pritur, më janë dukur të ëmbël!... ( Prapë puthë medaljonin): Të pres, Zef, edhe tre, edhe tridhjetë e tre vjet! Të pres, gjer në vdekje të pres!... Vetëm më vjen keq për rininë time dhe tënden, Zef. Sa më shumë kohë shkon që nga dita që u dashuruam, aq më shumë më forcohet shpresa se do të vish, Zef, Eja! Nita jote po të pret, siç pret lulja fluturën, si të ftohtë diellin!... ( E puth edhe njëherë medaljonin, e fsheh në gjoks e si e gëzuar thotë): Tani jam e kënaqur si të ishte Zefi duke më dëgjuar, sikur të ishte këtu, diku afër meje!... O, ti dielli im, Nxehe, o dielli im, një grimë edhe dashurinë e tij për mua!...

**14. Cilës gjini letrare i përket teksti i veçuar.**

1 pikë

**15. Medaljoni simbolizon:**

1. besën
2. tradhtinë
3. urrejtjen
4. vetminë

*Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.*

1 pikë



**16.** Nita paraqitet e veshur si mashkull për dy arsye. Cilat janë ato?

Arsyeja e parë: \_\_\_\_\_

1 pikë

Arsyeja e dytë: \_\_\_\_\_

1 pikë

**17.** Çfarë mishëron figura e Nitës në këtë vepër?

1 pikë

**18.** A) Cili është bashkëfolësi i Nitës?

1 pikë

B) Kujt i drejtohet Nita në fjalinë e fundit?

1 pikë

**19.** Përcakto gjininë, numrin, rasën dhe lakimin e emrave.

EMRI	GJINIA	NUMRI	RASA	LAKIMI
mendimet				
e darkës				
njeriu				

2 pikë





Lined writing area with horizontal lines and a dashed border.

Lined writing area with horizontal lines and a dashed border.

Lined writing area with horizontal lines and a dashed border.





## E PLOTËSON KOMISIONI PËR VLERËSIM

Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara në test: \_\_\_\_\_

Nota: \_\_\_\_\_

**KOMISIONI:**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

**VLERËSUESI KRYESOR:**

\_\_\_\_\_

Data \_\_\_\_\_ 20\_\_\_\_